



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/17

Datë: 27.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 64 dhe 66 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125 dhe nenin 11 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2020, nxjerr këtë:


V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi Drejtues i Shërbimit Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK).
2. Formohet Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik i Universitar të Kosovës, në përbërje të:
 - 2.1. Dr. Agreta Gecaj - Gashi - Qendra Klinike Universitare e Kosovës;
 - 2.2. Dr. Aida Rexhepi- Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
 - 2.3. Dr. Xhevat Jakupi - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike;
 - 2.4. Dr. Diana Dafota - Spitali i Përgjithshëm Gjakovë - në bazë të rotacionit dhe përmbushjes së indikatorëve të kualitetit të shërbimeve shëndetësore;
 - 2.5. Dr. Sadete Hadri - Shërbimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor;
 - 2.6. Dr. Mirsad Shkreta - Ministria e Shëndetësisë;
 - 2.7. Një (1) ekspert i menaxhmentit shëndetësor, i zgjedhur në bazë të konkursit publik.
3. Bordi Drejtues i përgjigjet dhe i jep llogari Qeverisë nëpërmjet Ministrit të Shëndetësisë.
4. Kryesues i Bordit Drejtues të SHSKUK emërohet Xhevat Jakupi nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, me mandat 1 vjeçar të cilin e pason me radhë në vitin e dytë përfaqësuesi i QKUK dhe në vitin e tretë përfaqësuesi i QKSUK.
5. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues është 3 (tre) vjeçar.
6. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 17/07 i datës 06.10.2017.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

- Bordi i zgjedhur me Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 17/07 i datës 06.10.2017, nuk i ka përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e rëndësishme të përcaktuara me nenin 12 të Statutit të SHSKUK-së dhe ka dështuar në arritjen e objektivave.
- Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës gjatë mandatit të këtij Bordi Drejtues, ka pasur menaxhim jo të mirë të shpenzimeve duke mos i marr parasysh nevojat dhe prioritetet e SHSKUK-së. Po ashtu ky Bord ka vepruar në shpërputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048 si dhe me Rregullën Financiare - Nr.01/2013 - Shpenzimi i Parave Publike, kjo e konstatuar në raportet e Zyrës së Auditimit të Brendshëm si dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit.
- Duke marrë parasysh gjendjen emergjencës për shëndetin publik të shpallur me Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020 dhe me qëllim të funksionimit të Bordit të SHSKUK-së dhe mbarëvajtjes së gjithmbarshme të punëve, përfshirë aktivitetet shëndetësore dhe administrative të njësive organizative të SHSKUK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/17
Datë: 27.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafit 1.11 të nenit 12 dhe nenit 89 të Ligjit Nr. 04/I-125 për Shëndetësi, në zbatim të nenit 41 dhe 44 të Ligjit nr. 02/I-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës aprovon kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së Corona virusit COVID-19 ku Plotësohet dhe ndryshohet pika e parë e Vendimit të Qeverisë nr. 01/15 të datës 23 mars 2020 si në vijim:
 - 1.1. Ndalohet qarkullimi i qytetarëve dhe automjeteve private gjatë orës 17:00-06:00 përveç nevojave mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë), dhe për shërbime dhe aktivitete që ndërlidhen me menaxhim të pandemisë (menaxhmenti dhe personeli esencjal qeveritar dhe komunal nga këta sektorë: shëndetësi, siguri dhe administratë shtetërore);
 - 1.2. Ndalohet qarkullimi i qytetarëve në zonat (sheshet) e hapura të qyteteve të Republikës së Kosovës, përveç banorëve të këtyre zonave dhe personave të autorizuar nga organet përkatëse;
 - 1.3. Barnatoret e licencuara në Republikën e Kosovës ushtrojnë veprimtaritë e tyre prej orës 06:00-17:00. Pas orës 17:00 veprimtaria e tyre do të organizohet përmes kujdestarisë. Barnatoret kujdestare do të përcaktohen nga Ministria e shëndetësisë/AKPPM në koordinim me Odën e Farmacistëve të Kosovës (OFK) dhe komunat përkatëse/autoritetet komunale;
 - 1.4. Shkelësit e këtyre masave të përcaktuara me këtë Vendim ndëshkohen sipas dispozitave ligjore në fuqi;
2. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë